



Pranuar / Dorezuar Prilmenoi/Prodato Received/Delivered	21-03-2023	3 viti god year	
Organ./Njesia Org./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shterja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHAK	2846/2023		112



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.333/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, në çështjen administrative sipas ankesës me numër A.nr.333/2023 të datës 08.02.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit/Shërbimi Korrektues i Kosovës, me bazë juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 21.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.333/2023 të datës 08.02.2023, të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, më datë 08.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1156/2023 të regjistruar nën shenjen A.nr.333/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokollit 27/KA të datës 29.12.2023 të Komisionet për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me pretendimin ankimor së vendimi i kundërshtuar nuk është i ligjshëm.

Ndërsa me datë 17.03.2023, ankuesi ka parashtruar kërkesën me numër protokollit 2761/2023 me të cilën ka tërhequr ankesën me numër A.nr.333/2023 të datës 08.02.2023.

Kolegji i Këshillit pas pranimit të kërkesës me numër protokollit 2761/2023, e në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 103 paragrafi 1 ku përcaktohet se: 1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë", vendosi që të përfundoj

procedurën administrative të iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.333/2023 të datës 08.02.2023.

Andaj, theksuar si me lartë, e në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.333/2023

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit.
- Udhëheqësit e Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

